



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 27.06.2012 në ora 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Rasim Demiri

Mungon: Mufera Sinik dhe Xhevdet Neziraj.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues nga zyra EU-së Visar Bivolaku, përfaqësuesi i OHCHR(Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut) - Xhemajl Ahmeti, përfaqësuesja nga Ambasada Zvicrane-Sakibe Jashari dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, zëvendëskryetari i pare i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbait të mbledhjes së kaluar.**
- 3. Rishqyrtimi i detyrave të dala nga Plani i Vepriimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për tremujorin e dytë, të vitit 2012**

Elmi Reçica- zëvendëskryesues— konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së kaluara.

Zëvendëskryesuesi – tha se procesverbalin është shpërndah me kohë dhe njëherit hapi debat nëse ka ndonjë vërejtje eventuale

Glauk Konjufca – sa i përket përmbajtjes së këtij procesverbali nuk ka vërejtje mirëpo ishte i mendimit që formulimi i procesverbaleve të kenë përmbajtje të përgjithshuar. Sa i përket mbledhjeve të kryesisë, procesverbalet përpilohen në formë të transkriptit mjaftë literal.

Propozoi i tij ishte që në të ardhmen procesverbalet e mbledhjeve të jenë sa më përmajtësore në mënyrë që të mos nënshtrohen ndërhyrjet arbitrare subjektive por të mbetet fjala besnike siq diskutohet në komision nga se korektësia dhe përgjegjësisia e fjalës publike e thënë na obligon ta rrujmë moralin public.

Zëvendëskryesuesi – u pajtua me propozimin e parafolësit duke u mbështet në faktet se ky komision ka një rëndësie të veçantë në Parlament.

Ai propozoi që stafi administrativ për mbështetje të komisionit ti drejtohet sekretarit të Kuvendit me kërkesë, të sigurohet një sallë e përhershme për mbajtjen e takimeve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, salla të jetë e modifikuar me pajisje për përktim dhe të nixirret transkripti i mbledhjeve.

Zëvendëskryesuesi – meqë procesverbalit në përmbajtje nuk kishte vërejtje, ai konstatoi se komisioni njëzëri miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 21.05.2012, pa vërejtje.

3. Rishqyrtimi i detyrave të dala nga Plani i Vepriimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropiane, për tremujorin e dytë, të vitit 2012

Zëvendëskryesuesi, tha se për këtë takim është caktuar vetm një pikë, Rishqyrtimi i detyrave të dala nga Plani i Vepriimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropiane, për tremujorin e dytë, të vitit 2012

Zëvendëskryesuesi – theksoi se në bazë të obligimeve dhe detyrave që dalin nga plani i veprimt për integritet Evropiane ka qen një prej aktiviteteve kryesore për këtë interval kohor ku dhe komisioni ka pas progress sidomos gjatë procedimit të ligjeve në parim dhe aprovimin e raporteve të komisioneve funksionale.

Propozimi i tij ishte që komisioni të deklarohet nëse ka propozime apo sygjerime lidhur me planin e veprimt për tremujorin e dytë

Glauk Konjufca – shprehu qëndrimin e tij se në shumë sfera çështjet e pazgjedhura kanë peshë të madhe dhe përgjegjësia bie mbi të gjith ne, por më së shumti është e obliguar Qeveria e cila duhet të bëjë përpjekje për fuqizimin e tyre.

Si çështje shqetësuese është niveli i lartë me prani të plumbit në zonën e Mitrovicë, i cili problem është evidentu qysh në vitin 2000.

Në bazë të raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë ndër të tjera thuhet se niveli i ndotjes me prani të plumbit te fëmijët e komunitetit rom gjakut i të cilëve është testuar konstatohet se është dhjetra here më i lartë se niveli i lejueshmëris. Theksoi se deri sot nuk është arrit ndonjë zgjidhje adekuata dhe se ky problem përsëritet në cdo raport ndërkombëtar. Në këtë kontekst komisioni ka obligim të jetë në nivel të detyrës që të mos lejohet kjo çështje të politizohet. Propozimi i tij ishte që komisioni të jetë më vigjilentë dhe në të ardhmen të mos figurohet si sfidë në raportin ndërkombëtar për Kosovën

Petar Miletic- në fjalën e tij tha se si Parlament dhe si komision është dhënë kontribut i mjaftueshëm sa i përket çështjeve për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shumicë

Ajo që konsiderohet mjaft e rëndësishme është se komisioni ka zbatuar procedurat si gjatë shqyrtimit të ligjeve në parim dhe njëherit janë miratuar shumë ligje, siç është ligji për Prizrenin, Ligji për Hoçën e Madhe dhe Ligji për RTK-në.

Në vazhdimësi tha se kur bëhet fjalë për ligjet që rrjedhin nga aneksi 5 i Pakos së Ahtisarit, komisioni i ka respektuar dhe realizuar detyrat që dalin nga kjo pako.

Si sfidë e cila bazohet në raportin e Planit të Veprimit të Kuvendit për integritet Evropian, ku bëhet fjalë për problemet e komunitetit shumic, janë obligime të cilat duhet angazhim më i madh, siç është procesi i liberalizimit të vizave, integriteti i komuniteteve në shoqërinë Kosovare.

Ai konsideron se në bashkëpunim me pushtetin ekzekutiv, do të bëhen përpjekje për përmbushjen e Standardeteve Evropiane që Kosova të jetë candidate për antarësim në BE-në.

Albert Kinolli – perkrah diskutimet e parafolësve duke konsideruar se ligjet të cilat janë procedu dhe miratu kanë peshën e vet dhe se këto çështje nuk duhet politizuar.

Ai konsideruar se secili komunitet i ka specifikat e veta dhe se pas periudhës konfliktuale komuniteti rom ka dhënë kontributin e vet në të gjitha proceset në të cilat ka kaluar Kosova, Nëse shiqohet realiteti, në pjesën veriore të Mitrovicës po rezikohet jeta e qytetarëve romë. Në shumë takime qeveritare dhe gjatë organizimit të tryezave të rrumbullakta janë diskutuar tema për të drejtat e pakicave por kjo çështje ka mbetur vetëm në letër nga se nuk janë ndërmarr veprime pozitive për komunitetin tone Me shembuj ceku se ende nuk është kryer vaksionimi i fëmijëve të komunitetit romë, pra niveli mbetet më i ulët se te komunitetet tjera

Sa i përket liberalizimit të vizave dhe procesit të riatdhesimit ka mbetur çështje jetike. Me theks të vacant tha se për këtë çështje janë institucionalizuar zyrat komunale për çështje të komuniteteve e të cilat kanë obligim të ofrojnë kontributin e tyre por deri sot kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur nga se ende ka njëzëri të cilët brendhin rrugëve ku ka raste që nuk iu është ofruar as ndihma emergjente.

Rasim Demiri – theksoi se ky komision ka punuar mjaft në shumë çështje, veçanërisht kur bëhet fjalë për interesat e komunitetit pakicë. Ai tha se në kuadër të planit të veprimit Komisioni është bazuar në ligjet që dalin nga Pako e Ahtisarit.

Në këtë aspekt komisioni ka miratuar ligjin për Prizrenin, Ligjin për Hoçëne e Madhe si dhe Ligjin për RTK-në dhe shumë ligje tjera.

Sa i përket çështjes së decentralizimit, ai u shpreh se komuniteti boshnjak është përkrahës i këtij procesi si të gjitha komunitetet tjera.

Kur bëhet fjalë për të arriturat në këtë sferë konsiderohet se komuniti boshnjak has në probleme në të gjitha komunat. Ai tha se këtë çështje e ka ngrit në Parlament, gjithashtu edhe në prani të z. Piter Fei, i cili ka dhënë premtime të shumta por deri sot nuk ka rezultate konkrete. Ai ceku se ka ngecje edhe në regjistrimin e statusit civil e cila është pengesë serioze. Ajo që konsiderohet e rëndësishme është se problemet e cekura për komuniteti boshnjak nuk janë të kënaqshme sa i përket procesit të integritimit në Bashkësin Evropiane.

Zëvendëskryesuesi – Theksoi se në bazë të planit të veprimit për integritim Evropian komisioni është i autorizuar që bashkarisht të zgjidhen dhe të ndahen përgjegjësit.

Në kuadër të temës së ngritur nga z. Miletic, shihet se një pjesë të obligimeve janë realizuar me sukses. Ndërsa ka detyra të cilat dalin nga Traktatet dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare, e të cilat nuk janë realizuar, nga se edhe ekziston kjo situatë në Kosovë.

Kur bëhet fjalë për decentralizimin, kjo çështje është ngritur nga z. Demiri edhe në Kuvend.

Ai konsideron se lidhur me këtë temë ekzistojnë mekanizma të cilët janë duke punuar drejt decentralizimit të komunave nga se në këtë drejtim hapen rrugët drejt integritimit në BE.

Sa i përket çështjeve të ngritura nga parafolësit lidhur me nivelin e ndotjes me prani të plumbit në pjesën e Mitrovicës dhe lidhur me çështjen e vaksionimit, kërkoi që komisioni në këtë drejtim të jetë më konstruktiv dhe të marrë veprime konkrete në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në bazë të çështjes së ngritur më lartë, zëvendëskryesuesi konstatoi se komisioni në mbledhjen e rradhës do të thërras përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë që të ofrojnë informata lidhur me kontrollin dhe trajtimin nga kontaminimi me plumb dhe gjendjen shëndetësore që prekin jetën e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Elmi Reçica